

Data_____

PROCES - VERBAL
Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Sherbimi i GPS për mjetet motorike te OSSH sh.a.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72267100-0, Mirembajtja e Softwareve te Teknologjise se Informacionit.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **3,000,000 (Tre milion) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar proces - verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit eshte nen kufirin e ulet monetar. Ne perputhje me nenin 33 te LPP dhe VKM 291 DT. 15.05.2024, kufijte monetare jane:

KREU II KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Per sa mesiper, referuar Nenit 49 te LPP ku shprehet qe Autoriteti kontraktor mund te perdore proceduren e hapur te thjeshtuar per kontrata nen kufirin e ulët monetar, AK ka vendosur qe Procedura te jete e hapur e thjeshtuar – Sherbime.

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Sistemi i HR & Payroll përdoret nga Departamenti i Burimeve Njerëzore prej vitit 2015. Ne kuader te ndarjes se OSHEE GROUP sh.a dhe krijimit te kompanive te reja duhet qe ne vazhdimesi te kryhet mirembajtja, pershtatja e legjislacionit ne fuqi, ne procesin e organizimit te kompanive te reja. Per kete arsye nevojitet qe sistemi i HR & Payroll te mirembahet sebashku me modifikimet e nevojshme.

Duke qene se mirembajtja dhe ndryshimet jane te domosdoshme here pas here, programi i burimeve njerezore ka nevojë per suport profesional nga kompani te specializuara per mirembajtjen e sistemit dhe perditesimet e legjislacionit qe lidhen me llogaritjen e pagave. Qëllimi i këtij projekti është qe te behen zhvillimet e reja ne sistemit HR & Payroll, përmirësimi i vazhduar dhe integrimi i proceseve te reja të punës lidhur me administrimin e burimeve njerezore dhe llogaritjes se pagave ne sistemin egzistues për të rritur efektivitetin e të gjithë përdoruesve nepermjet automatizimit. Qe te realizohen te gjitha keto, duhet qe operatori te jete i azhornuar me c do hap, per kete arsye nuk mund te ndahet dhe ne lote.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi

mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1,000,000 (Nje milion) leke pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 dhe pika 4 e nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë, fondin limit të kësaj kontrate, OE ofertues duhet të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën 1,000,000 (Nje milion) leke pa TVSH, duke qendruar madje brenda normes prej 40 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, norme që përcaktohet si limit i mundshëm nga LPP 162/2020 dhe në nenin 55 pika 4 e VKM 285/2021 e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore,*”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedure është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete jo më tepër se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se:” Autoriteti / enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori

ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. “*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per:

Sherbime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 500,000 (Peseqind mije) leke dhe që është që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- *Për sherbime te mëparshme të realizuara me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohe vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.*
- *Në rastin e sherbimeve të mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 si dhe pika 4 e nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 17 % të vlerës së fondit limit, (e rumbullakosur).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore për vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme, ka arsyetuar të jete brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001:2015** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), **ISO 27001:2013 (ose versioni i perditesuar)** ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese.

Certifikimi **ISO 27001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë edhe furnizime të reja në sistemet ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të ketë të punësuar ose me kontratë bashkepunimi jo më pak se 3 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj).

Plotesimi i këtij kriteri përmbushet me paraqitjen e formulareve E-SIG për muajin e fundit duke ju referuar datës së hapjes së ofertave, diplomave të shkollimit të lartë universitar dhe CV Personale për secilin prej punonjësve, kontratës së punës ose kontratës së bashkepunimit në formatin e përcaktuar nga ligji e vlefshme për të gjithë kohezgjatjen e shërbimit objekt kontrate.

Nga sa mesiper, duhet të ketë (në stafin e tij ose me kontratë bashkepunimi) të certifikuar si mëposhte:

- a. Të paktën 1 punonjës të certifikuar nga Microsoft (*platforma ASP.NET*) ose Oracle (*platforma JAVA EE*) ose Zend (*PHP Engineer*) ose ekuivalent të nivelit të avancuar në teknologjinë e programimit e cila është përdorur për zhvillimin e sistemit që ofrohet.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim baze të dhënash ose ekuivalent.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektesh ose ekuivalent.

Ku të vertetohet nëpërmjet paraqitjes së Certifikatës të vlefshme, një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës ose kontrata e bashkepunimit në formatin e përcaktuar nga ligji e vlefshme për të gjithë kohezgjatjen e shërbimit objekt kontrate dhe certifikimet sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente.

Theksojmë se ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

“Në çdo rast, përpara nënshkrimit të kontratës, ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personel te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Per te siguruar qe ne kuader te mirembajtjes, ndryshimet, pershtatjet dhe modifikimet e nevojshme ne sistemi, do te kryhen me pergjegjesi profesionale dhe me cilesi, eshte e domosdoshme qe Operatori Ekonomik te kete ne stafin e vet te pakten 1 punonjes me njohuri te certifikuara per ciklin e zhvillimit software.

Nje ekspert i bazës së të dhënave është thelbësore në dizanjimin, optimizimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave komplekse. Një profesionit i tillë sjell përvojë në trajtimin e të dhënave në shkallë të gjerë, sigurimin e performances së lartë dhe zbatimin e masave të sigurisë. Përvoja është thelbësore për parashikimin e problemeve të mundshme, optimizimin e performancës dhe sigurimin e integritetit të të dhënave në të gjithë sistemin. Për më tepër, ai duhet udhëheq në zgjedhjen e teknologjive më të përshtatshme të bazeë së të dhënave për këtë sistem të OSHEE duke i integruar ato pa problem me arkitekturen e software-it dhe duke shkallëzuar infrastrukturen e bazës së të dhënave për të trajtuar në mënyre efikase vëllimet në rritje të të dhënave.

Planifikon, implementon dhe menaxhon strukturën dhe operacionet e bazave të dhënash në projektin HR, duke siguruar performancën dhe integritetin e të dhënave. Projekton dhe optimizon bazat e dhënash për aplikacione HR, duke siguruar që ato të jenë të shkallëzueshme dhe të përshtatshme për nevojat e projektit.

1 (një) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektesh ose ekuivalent. garanton AK që operatori ekonomik ka në përbërje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet konform të gjitha kërkesave dhe afateve të përcaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerzve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit HR. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: specifikimet teknike, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjese ne DST e kesaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.